



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Pranuar - Pranimje Mënyesë			
10.11.2011			
Nr. i organit Org. b. o. j	Num. i...	Shkollë Paloq...	Mera Kryesore
01-013/1502			

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Bazuar në nenin 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 2008/28 dhe nenit 36.1 dhe 36.2 shkronja 2) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 09.11.2015 aprovon këtë:

## V E N D I M

PËR SHPALLJEN E DISKUTIMIT PUBLIK PËR PROPOZIM RREGULLOREN MBI PËRSHKRIMIN E DETYRAVE TË PUNËS TË PUNËTORËVE ARSIMOR DHE ORGANIZIMIN E PUNËS NË INSTITUCIONET EDUKATIVO-ARSIMORE NË KOMUNËN E VITISË

### I.

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, SHPALL diskutim publik për propozim Rregulloren mbi përshkrimin e detyrave të punës të punëtorëve arsimore dhe organizimin e punës në institucionet edukativo arsimore në Komunën e Vitisë.

### II.

Propozim Rregullorja mbi përshkrimin e detyrave të punës të punëtorëve arsimore dhe organizimin e punës në institucionet edukativo arsimore në Komunën e Vitisë, do të jepet në diskutim publik deri më 20 nëntor 2015

### III.

Debati me publikun do të mbahet më 20 nëntor 2015 në ora 10,00 në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë,

### IV.

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

### V.

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për propozimet e bëra për propozim Rregulloren mbi përshkrimin e detyrave të punës të punëtorëve arsimore dhe organizimin e punës në institucionet edukativo arsimore në Komunën e Vitisë.

### VI.

Materiali lidhur me propozim Rregulloren mbi përshkrimin e detyrave të punës të punëtorëve arsimore dhe organizimin e punës në institucionet edukativo arsimore në Komunën e Vitisë, mund të merret në Drejtorinë e Arsimit, Shërbimin e Kuvendit, Zyrën Ligjore dhe i njëjti do të jetë i shpallur në tabelën e shpalljeve dhe në Veb faqen e Komunës së Vitisë në internet.

### VII.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

